

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

Politikë Tarifore për Furnizim të Ujit

Dhjetor 2007

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

Misioni

“Ofrimi i shërbimeve kualitative, efikase dhe të qëndrueshme, të gjithë konsumatorëve në Kosovë nga ana e kompanive të ujit dhe mbeturinave të ngurta.”

Vizioni

“Rregullimi i sektorëve të ujit dhe mbeturinave të ngurta me anë të metodave transparente dhe të drejta në pajtim me praktikën e mirë europiane e cila garanton sigurimin e shërbimeve kualitative, të qëndrueshme, të pranueshme dhe të sigurta nga ana e kompanive të ujit dhe mbeturinave të ngurta kudo në Kosovë, duke respektuar mjedisin dhe shëndetin publik”

Politikë Tarifore për Furnizim të Ujit

Përmbajtja

1.	HYRJE.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
1.1	DISPOZITAT E VENDOSJES SË TARIFAVE TË RREGULLORËS SË ZRRUM-IT (RREGULLE E UNMIK-UT NR. 2004/49)	1
1.2	OBJEKTIVAT	1
2.	JURISDIKSIONI.....	2
2.1	OFRUESITË E SHËRBIMEVE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.	OPCIONET KRYESORE TË POLITIKËS TARIFORE. ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.	
3.1	DREJTËSI SOCIALE DHE STRUKTURAT E TARIFAVE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.1.1	<i>Roli i ofruesve të shërbimeve lidhur me përgjegjësinë sociale</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.1.2	<i>Uniformiteti i tarifave</i>	<i>3</i>
3.1.3	<i>Grupet e konsumatorëve.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.1.4	<i>Bllok-tarifat dhe tarifat bazike</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.1.5	<i>Tarifat mujore fikse.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.2	NIVELET E SHËRBIMIT	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.3	ZGJERIMI I SHËRBIMIT	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.3.1	<i>Taksat e kyçjes.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.3.2	<i>Taksat për zhvillimin e infrastrukturës.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.4	FAKTORËT MJEDISOR.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.4.1	<i>Kontrolli mbi shfrytëzimin e ujit</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.4.2	<i>Taksat për marrjen e ujit</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.4.3	<i>Menaxhimi i humbjeve të ujit.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.4.4	<i>Përputhje me standardet e mjedisit</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.5	MBULIMI I KOSTOS.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.5.1	<i>Përkufizimi</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.5.2	<i>Koha e duhur për arritjen e mbulimit të plotë të kostos.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.5.3	<i>Pritjet e efijencës.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.5.4	<i>Mbulimi i kostove kapitale të investimeve</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.5.5	<i>Grantet dhe asetet e dhuruara</i>	<i>9</i>
3.6	STRUKTURA E KAPITALIT, VLERA DHE KTHIMI I KAPITALIT	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
3.6.1	<i>Struktura e kapitalit</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.6.2	<i>Vlera rregullatore e kapitalit.....</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.6.3	<i>Kapitalit i punës</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>

3.6.4	<i>Kthimi në kapital</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
3.6.5	<i>Procesi i vënies së tarifave</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
4.	PROCESI	12
4.1	SHQYRTIMET KRYESORE TË TARIFAVE	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
4.2	SHQYRTIMET E PËRKOHSHME	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

1. HYRJE

1.1 Dispozitat e vendosjes së tarifave të Rregullorës së ZRRUM (Rregullore e UNMIK-ut Nr. 2004/49)

Kjo politikë e lëshuar nga Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) paraqet interpretimin dhe elaborimin e obligimeve ligjore lidhur me tarifat e rregulluara për shërbimet e furnizimit me ujë.

Veçanërisht, sipas Nenit 38 të Rregullorës së ZRRUM-it (*Rregullat e lëshuara nga Rregullatori*) kërkohet që ZRRUM-i të krijojë rregulla për vendosjen dhe aprovimin e tarifave. Kjo politikë është bazë mbi të cilën vendosen rregullat e tilla të detajizuara.

Neni 10 i Rregullorës së ZRRUM-it përshkruan obligimet e caktuara të vënies së tarifave duke përfshirë:

- Procesin e konsultimit (10.2)
- Pritjet e efijencës (10.3 b)
- Taksat e kyçjes që përmbushen nga konsumatorët (10.3 c)
- Mjaftueshmërinë për përmbushjen e kostove kapitale dhe kostove tjera (10.3 d)
- Harmonizimin e tarifave (10.3 e)

Obligimet ligjore siç është paraparë në Rregulloren e ZRRUM-it, lejojnë një shkallë të diskrecionit rregullativ të bazuar në gjykimin profesional, kuptimin e entiteteve rregullative (dhe rrethanave specifike të tyre) dhe kriterin socio-ekonomik.

Si vazhdim të procesit inicial të konsultimit, në Maj 2007 dhe pikëpamjeve pasuese të palëve të interesit është përfunduar kjo pasqyrë e politikave siç është përcaktuar më poshtë.

1.2 Objektivat

Interesat e palëve të ndryshme nuk përputhen domosdo; për shembull interesat e konsumatorit për çmimet e ulëta janë kontradiktore me interesat e investitorëve në qëndrueshmërinë financiare. Është detyrë e ZRRUM-it të sigurojë që çmimet të japin një balancim optimal në mes të këtyre interesave dhe vlerë më të mirë të mundshme duke përfshirë çmimin dhe kualitetin e përmirësuar të shërbimit për shoqërinë. Kjo politikë tarifore është

përpiluar në atë mënyrë që të sigurojë balancimin më të mirë të përgjithshëm.

2. JURISDIKSIONI

2.1 Ofruesitë e shërbimeve

Ky dokument i politikave është i bazuar në mjedisin aktual institucional ku ndërmarrjet publike të ujit në shtatë regjione janë ofruesitë e vetëm të shërbimeve urbane të ujit që funksionojnë mbi bazën e monopoleve lokale. Tarifat për shërbimet e ujit me shumicë që ofrohen sektorëve të energjisë dhe atyre bujqësore nga NPH 'Ibër Lepenci' si dhe disa ndërmarrjeve publike të ujit duhet të adresohen në pjesën plotësuese të kësaj politike.

WSPS 1: Jurisdiksioni

Kjo politikë e tarifave zbatohet për aktivitetet e shtatë ndërmarrjeve publike të ujit dhe nuk zbatohet për shërbimet e ujit me shumicë të ofruara nga NPH 'Ibër Lepenci'.

3. OPCIONET KRYESORE TË POLITIKËS TARIFORE

3.1 Drejtësia shoqërore dhe strukturat e tarifave

3.1.1 Roli i ofruesve të shërbimeve lidhur me përgjegjësinë sociale

Rregullorja 2004/49 (Neni 10.3 (f)) konstaton që tarifat duhet të përcaktohen në pajtim me 'përgjegjësia e Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes e jo të ofruesve të shërbimeve është që të ndihmojë konsumatorëve me të ardhura të ulëta për të paguar faturat e tyre'. Si pasojë e kësaj, ofruesitë e shërbimeve duhet të lejohen që të funksionojnë plotësisht mbi bazën komerciale.

WSPS 2: Përgjegjësia sociale

Qeveria (lokale dhe qendore) është përgjegjëse për përmbushjen e nevojave të të varfërve duke përfshirë ndihmën për kryerjen e shpenzimeve të shërbimeve publike.

3.1.2 Uniformiteti i tarifave

Është e njohur që shpenzimet të shërbimeve të ujit do të ndryshojnë ndërmjet ndërmarrjeve publike për shkak të shfrytëzimit të resurseve, ekonomive të shkallës, topografisë dhe faktorëve tjerë. Gjithashtu, shpenzimet e shërbimeve brenda shërbimit të ndërmarrjeve publike ka mundësi të ndryshojnë sipas sistemit dhe vendit për arsye të njëjta. Tarifat afatshkurtëra dhe afatmesme duhet të jenë uniforme në çdo zonë të shërbimit të ndërmarrjeve publike. Për periudhë afatgjate, ZRRUM-i duhet ta marr parasysh mundësinë që të vendos tarifat të cilat reflektojnë shpenzimet sipas vendit ose sistemit por vetëm kur sistemet të raportimit financiar dhe teknik janë mjaft të fuqishëm që të mundësojnë analizën më të detajzuar siç edhe është kërkuar.

WSPS 3: Uniformiteti i tarifave

Tarifat duhet të jenë të njëtrajtshme në çdo zonë të shërbimit të ndërmarrjeve publike në afat të shkurtë dhe të mesëm por për periudhën afatgjate duhet të konsiderohen tarifat variabile që reflektojnë shpenzimet brenda zonës së shërbimit në zonën e shërbimit që i nënshtrohen zotimeve dhe mjaftueshmërisë së raportimit financiar dhe teknik.

3.1.3 Grupet e konsumatorëve

Kostot sipas njësive mund të dallojnë tek grupet e ndryshme të konsumatorëve, p.sh. kosto për njësi të furnizimit për numrin e madh të konsumatorëve industrial mund të jetë dukshëm më i ulët se sa të konsumatorëve shtëpiak. Në anën tjetër, konsumatorët shtëpiak mund të kenë pengesa të përballueshmërisë me të cilat nuk janë sprovuar konsumatorët jo-shtëpiak. Sipas kësaj politike tarifore, gjatë periudhës së shkurt kohore, pengesat e përballueshmërisë mund të kenë ndikim në eficiencën ekonomike por me kohë struktura e tarifave duhet më shumë të reflektojë shpenzimet.

Në periudhë afatshkurte, tarifat duhet të vendosen mbi bazën e pengesave të përballueshmërisë por në atë afatmesme, ato duhet të kalojnë në tarifa uniforme. Në periudhë afatgjate, konsumatorët individual të shkallës së lartë, p.sh. industria e rëndë dhe aktivitetet e prodhimit të energjisë, mund t'i diskutojnë tarifat e ulura që reflektojnë shpenzimet reale të kostos reale të furnizimit.

3.1.4 **Bllok-tarifat dhe tarifat bazike**

Meqë ka argumentime sociale lidhur me tarifën bazike, d.m.th. tarifa e ulur për vëllimin e ujit që është i nevojshëm për nevoja bazike, ekzistojnë edhe shumë pengesa ekonomike dhe praktike të strukturave të tarifave sidomos sa i përket jo praktikitetit të aplikimit të sistemit të tillë në apartamente që kanë kycje individuale. Kështu që koncepti i bllok-tarifave dhe tarifave bazike nuk përkrahet nga ZRRUM-i dhe struktura aktuale e tarifave volumetrike uniforme duhet të mbetet.

WSPS 4: Bllok-tarifat dhe tarifat bazike

Struktura e tarifave duhet të jetë uniforme sipas sistemit aktual

3.1.5 **Tarifat mujore fikse**

WSPS 5: Tarifat mujore fikse

Ofruesitë e shërbimeve duhet të kenë të drejtën e imponimit të tarifës fikse mujore por vlera duhet të kufizohet në jo më shumë se shpenzimet e aktiviteteve të shërbimit të konsumatorëve, p.sh. leximi i ujëmatësit, zëvendësimin e ujëmatësit. Në afat të mesëm deri te ai më i gjatë, struktura e tarifave mund të përcaktohet në atë mënyrë që t'i lejojë konsumatorët të zgjedhin tarifën volumetrike pa atë fikse.

3.2 **Nivelet e shërbimit**

Dihet që niveli i shërbimeve në shumë zona është nën nivelet e pranueshme minimale (standartet BE ose të ngjajshme). Është e diskutueshme çështja që konsumatorë të cilët vuajnë nivelet e ulëta të shërbimeve duhet të paguajnë tarifën e ulët sipas njësisë se sa ata të cilët kanë nivelin e lartë të shërbimeve. Sidoqoftë, është jo praktike që tarifatat të vendosen mbi këtë bazë dhe mekanizmat kompensues alternativ do të zbatoheshin më mirë.

WSPS 6: Nivelet e shërbimit

Tarifatat nuk duhet të ndryshojnë sipas nivelit të shërbimit. Sidoqoftë, ZRRUM-i duhet të përdorë fuqinë e tij rregullatore për të përmbushur standartet minimale të kualitetit dhe të shërbimeve.

3.3 Zgjerimi i shërbimeve

3.3.1 Taksat e kyçjes

WSPS 7: Taksat e kyçjes

Ofruesitë e shërbimeve mund të aplikojnë taksat e kyçjes me qëllim që të mbulojnë shpenzimet e gypeve, valvulave, ujëmatësit etj. si dhe taksën administrative siç edhe përdoret tani. Taksat e tilla mund të paguhen nga agjencitë donuese për rastet sociale.

3.3.2 Taksat për zhvillimin e infrastrukturës

Zgjerimi i shërbimeve paraqet kërkesa shtesë të infrastrukturës për ofruesitë e shërbimeve, p.sh. shtrirja e rrjetit, pajisjet e pompimit etj. Proporcioni i dukshëm i kërkesës për zgjerimin e shërbimeve të furnizimit me ujë është i përshtatshëm për apartamentet e reja dhe kërkesave komerciale/industriale. Në rastin e apartamenteve, ato financohen nga Ndërmarrësit se sa nga amvisëritë individuale. Kështu që imponimi i tarifave të zhvillimit të infrastrukturës tek ndërmarrësit dhe ndërmarrjeve të reja komerciale/industriale konsiderohet si i drejtë dhe i arsyeshëm.

WSPS 8: Taksat për zhvillim të infrastrukturës

Ofruesitë e shërbimeve duhet të imponojnë tarifën për zhvillimin e infrastrukturës në zhvillimet e reja për të mbuluar shpenzimet e zgjerimit të shërbimeve me qëllim që t'i përmbush kërkesat e rritura të ujit. Vlera e tarifës duhet të jetë e barabartë me shpenzimet marginale afatgjata të investimeve të nevojshme kapitale të llogaritura në bazë të përmasave të banesave ose në rast të çështjeve komerciale/industriale, shumës së përcaktuar në bazë të kërkesës së pritur. Ndërmarrësi mund të kontribuoj në tarifën e zhvillimit të infrastrukturës ose mund të vendos të paguajë për një periudhë më të gjatë (maksimum 10 vite) me pagesë vjetore të përcaktuar në bazë të vlerës aktuale neto në shkallën e drejtë të zbritjes duke reflektuar shpenzimet e kapitalit të ofruesve të shërbimeve.

Në afat të shkurtë, me mundësi të të dhënave të detajizuara sa i përket shpenzimeve të zgjerimit të infrastrukturës, ofruesitë e shërbimeve duhet jenë gjendje të imponojnë pagesën paushall për banimet e reja në shumën e vendosur nga ZRRUM-i.

3.4 Faktorët mjedisor

3.4.1 *Kontrolli mbi shfrytëzimin e ujit*

Nuk është as praktike dhe as e përshtatshme që në afat të shkurtë kohor të imponohen strukturat menaxhuese të tarifave (tarifat për konsumin e lartë të vendosura në nivelin e lartë për të penguar konsumin e tepruar). Në të ardhmën, ZRRUM-i mund të lejojë strukturat menaxhuese të tarifave duke u bazuar në të dhënat e sigurta të pengesave të burimit të ujit. Strukturat e tilla duhet të zbatohen në atë mënyrë me të cilin ofruesitë e shërbimeve nuk mund të marrin fitim shtesë nga to.

WSPS 9: Strukturat e tarifave të menaxhimit të kërkesës ZRRUM-i nuk duhet të vendos tarifave menaxhuese të kërkesës për afat të shkurtë (deri pesë vite) megjithëse duhet lënë opcionin që ky koncept të pranohet në të ardhmën pasi që ZRRUM-i ka përgatitur hulumtimin për domosdoshmërinë dhe zbatueshmërinë e menaxhimit të kërkuar.

3.4.2 *Taksat për marrjen e ujit*

Aktualisht, ofruesitë e shërbimeve paguajnë taksa për marrjen e ujit të papërpunuar. ZRRUM-i e përkrah imponimin e taksave të tilla duke pasur parasysh përmbushjen e kostos ekonomike të ujit dhe të stimulimit të cilin e siguron për reduktimin e humbjeve të ujit.

WSPS 10: Taksat për marrjen e ujit të papërpunuar Imponimi i taksave për marrjen e ujit të papërpunuar është i përkrahur nga ZRRUM-i.

3.4.3 *Menaxhimi i humbjeve të ujit*

Pavarësisht nga komplikimet e vlerësimeve të shpenzimeve dhe përfitimeve të kontrollit të humbjeve të ujit, ZRRUM-i përkrah konceptin e rrjedhjeve të nivelit të tij ekonomik, d.m.th. ku shpenzimet e reduktimit të mëtejshëm të rrjedhjeve i tejkalojnë përfitimet. Sidoqoftë, në afat të shkurtë, është e njohur që nivelet e rrjedhjeve, duke u bazuar në gjykimin shkencor dhe në krahasim me industrinë efektive të furnizimit me ujë kudo në botë, janë të mira në tejkalojnë e niveleve të tyre ekonomike dhe që reduktimet duhet të jenë të arritshme dhe ekonomisht të suksesshme.

Në periudhë afatshkurte, ZRRUM-i duhet të vendos çaqe për nivelet e shërbimeve dhe ujin e faturuar ndërsa në afat të mesëm dhe afatgjatë, çaqet duhet të jenë të "nivelet ekonomik të rrjedhjeve". ZRRUM-i duhet të monitorojë aktivitetet kontrolluese të humbjeve për të siguruar që humbjet mbahen në nivelin ekonomik dhe të mirren parasysh në strukturën e tarifave. Metodologjia e përcaktimit të tarifave duhet të konsiderojë bilancin në mes të shpenzimeve të krijimit të burimeve të reja të ujit dhe shpenzimeve të kontrollit të humbjeve.

3.4.4 Përputhshmëri me standardet e mjedisit

Nuk është praktike të kërkohej nga ofruesitë e shërbimeve të jenë në pajtim të plotë me standardet të BE dhe Kosovës mbi mbrojtjen e mjedisit. Qasja fazore në arritjen e pajtimit është më e përshtatshme. Koha për përputhjen me standardet dhe çfarëdo standarde të përkohëshme nuk përcaktohet nga ZRRUM-i por është përgjegjësi e qeverisë.

WSPS 11: Përputhje me standardet e mjedisit

Përputhja me obligimet e mjedisit bëhet në pajtim me kohën e përcaktuar nga qeveria gjatë së cilës kompanitë mund të ndërmarrin investime të nevojshme dhe kostot të përfshihen në mënyrë graduale gjatë investimeve të tilla.

3.5 Mbulimi i kostos

3.5.1 Përkufizimi

Mbulimi i kostos është i nënshtruar ndaj definicioneve të ndryshme. ZRRUM-i konsideron që mbulimi i kostos duhet të jetë i mjaftueshëm për Ndërmarrjet Publike t'i financojnë aktivitetet e tyre dhe të fitojnë kthimin në kapital që kanë investuar. Metodologjia e detajuar do t'i vendos mekanizmat për përcaktimin e tarifave të cilët mund të arrijnë këtë qëllim përmes krijimit të udhëzuesve rregullator të kontabilitetit. Kjo përfshinë adoptimin e qasjes së "menaxhimit të aseteve" në mirëmbajtjen e kapitalit të aseteve nëntokësore, të përcaktuara nga Zyra për Shërbimet e Ujit, rregullatori ekonomik i ujit dhe ujërave të zeza për Anglinë dhe Uellsin.

WSPS 12: Përkufizimi i mbulimit të kostos

Mbulimi i kostos definohet si niveli i të hyrave që është i mjaftueshëm për të financuar aktivitetet e tyre plus kthimin e arsyeshëm në kapital që ata kanë investuar por ende ofrojnë shërbimin në pajtim me kërkesat e tyre ligjore dhe rregullative.

3.5.2 Koha e duhur për arritjen e mbulimit të plotë të kostos

Me marrjen e pozitës inicuese në hapjen e vlerës rregullative kapitale të aseteve mbi të cilin mund të arrihet kthimi, është e mundur që të ketë avancime automatike drejt mbulimit të plotë të kostos, d.m.th. me rritjen e vlerës rregullative me investimet e reja rritet edhe kthimi në kapital. Në kushtet afatgjata mund të arrihet mbulimi i plotë i kostos, koha e cila do të varet nga shkalla dhe kohëzgjatja e investimeve të reja në sektor.

WSPS 13: Afati kohor për arritjen e mbulimit të kostos

Mbulimi i kostos duhet menjëherë të arrihet në mënyrë efektive duke qenë i mjaftueshëm për financimin e aktiviteteve të ofruesve të shërbimeve por kthimi në kapital duhet të rritet vazhdimisht me ndërmarrjen e investimeve të reja në sektor.

3.5.3 Pritjet e efijencës

Tarifat duhet të reflektojnë pritjet reale por megjithatë sfiduese të efijencës së përmirësuar të ofruesve të shërbimeve posaçërisht performancën e përmirësuar të inkasimit dhe reduktimet në Ujin e Pa Faturuar (UPF, përfshirë humbjet fizike d.m.th. rrjedhjet dhe humbjet komerciale d.m.th. leximi jo i drejtë i ujëmatësve dhe kyçjet ilegale).

Pritjet duhet të përcaktohen nga ZRRUM-i në konsultim me secilën kompani, AKM-në (ose institucionin pasues të saj) dhe Bordin Mbikëqyrës/Drejtues të KLMC-së.

WSPS 14: Pritjet e përmirësimit të efijencës

ZRRUM-i duhet të vendos pritjes e përmirësimit të efijencës në konsultim me kompanitë, AKM-në (ose institucionet pasuese të tyre) dhe bordet e tyre përkatëse të mbikëqyrjes. Qëllimet duhet të jenë reale por megjithatë sfiduese.

3.5.4 **Mbulimi i kostos kapitale të investimeve**

Me zbatimin e qasjes së menaxhimit të asetëve, ZRRUM-i duhet të aplikojë metodologjitë e ndryshme për mbulimin e investimeve kapitale. Parimet themelore janë:

- Amortizimi nuk duhet të aplikohet në grantet e financuara apo asetet e dhuruara ose, përndryshe duhet të balancohet me amortizimin e njëjtë të vlerës së asetëve ose granteve.
- Investimet e reja për përmirësimin e shërbimeve duhet të përfshihen në vlerën kapitale rregullatore por amortizimi duhet të ngarkohet vetëm për asetet mbitokësore jo infrastrukturore dhe nuk duhet të ngarkohet për asetet nëntokësore ku vlerat e tyre duhet të jenë afatgjate.
- Mirëmbajtja kapitale (riparimi dhe zëvendësimi) e infrastrukturës duhet të konsiderohet si shpenzim me të cilat ngarkohen tarifat bazuar në planet e menaxhimit të asetëve
- Në bazë të asaj që ofruesitë e shërbimeve duhet të kenë të drejtë për kthimin në investimet e infrastrukturës dhe se mirëmbajtja e kapitalit është e përfshirë në shpenzimet, atëherë nuk ka arsyetim që amortizimi të konsiderohet në asetet e tilla.
- Kudo që përfshihet amortizimi, ai duhet të llogaritet mbi bazën e shpenzimeve aktuale të cilat duhet të bazohen në shpenzimet historike të korigjuara përmes formulës së thjeshtë të RPI indeksimit derisa nuk zhvillohet një qasje më e përshtatshme.

WSPS 15: Mbulimi i kostove kapitale të investimeve

Investimet kapitale të bëra nga ofruesitë e shërbimeve duhet të kthehen me anë të aplikimit të qasjes së menaxhimit të asetëve ku mirëmbajtja e kapitalit të infrastrukturës konsiderohet si shpenzim ndërsa shpenzimet e amortizimit aplikohen në asetet jo të infrastrukturës. Amortizimi duhet të aplikohet në ato asete të financuara nga ofruesitë e shërbimeve.

3.5.5 **Grantet dhe asetet e dhuruara**

Ofruesitë e shërbimeve nuk duhet t'i kompenzojnë investimet të cilat nuk i ka financuar, p.sh. grantet dhe asetet e dhuruara. Si

pasojë e kësaj, amortizimi i aseteve të tilla nuk duhet të përfshihet në tarifa. Në mënyrë të ngjajshme, mirëmbajtja e kapitalit në asetet e infrastrukturës të financuara nga grantet nuk duhet të ngarkohet përmes tarifave.

Trajtimi i granteve dhe aseteve të dhuruara

ZRRUM-i duhet t'i trajtojë asetet e siguruara nga grantet dhe asetet e dhuruara në mënyrë të ndryshme nga asetet e financuara përmes resurseve financiare të ofruesve të shërbimeve. ZRRUM-i duhet t'i aplikojë rregullat për amortizimin që në mënyrë të drejtë reflekton kthimin e kapitalit të investuar dhe në pajtim me konceptin e menaxhimit të aseteve.

3.6 Struktura e kapitalit, vlera dhe kthimi i kapitalit

3.6.1 Struktura e kapitalit

Teoria ekonomike konvencionale tregon se struktura e kapitalit nuk ka kurfarë ndikimi në performancën e biznesit dhe si e tillë është çështje e menaxhimit të KLMC-së e jo çështje rregullatore. Kështu që kthimi në kapital (kur të zbatohet) duhet të bazohet në kthimin e vlerës totale të kapitalit duke përfshirë edhe vlerën e borxhit.

WSPS 16: Struktura e kapitalit

Struktura e kapitalit të ofruesve të shërbimeve duhet të përfshihet në procesin e vendosjes së vlerës origjinale rregullatore kapitale të aseteve mbi të cilin mund të arrihet kthimi në kapital.

3.6.2 Vlera rregullatore e kapitalit

Vlera rregullatore e kapitalit (VRRK) definohet si vlera e aseteve mbi të cilën mund të fitohet kthimi. Në fillim, vlera kapitale rregullatore duhet të llogaritet si vlera e borxhit plus kapitali i punës plus investimet e financuara përmes resurseve financiare të Ndërmarrjeve Publike (me përjashtim të borxheve) plus vlera nominale të aseteve (të dhuruara) të mbetura (që mund të jetë zero). Investimet pasuese (me përjashtim të mirëmbajtjes kapitale në asetet e infrastrukturës) pa amortizim duhet të përfshihen në vlerën kapitale rregullatore. Në pajtim me konceptin e menaxhimit të aseteve, VRRK duhet të përshtatet me inflacionin në shqyrtimet e periodike të tarifave.

WSPS 17: Vlera rregullatore e kapitalit (RCV)

ZRRUM-i duhet të vendos vlerën rregullatore të kapitalit (VRK) për secilin ofrues të shërbimeve të bazuar në nivelin e borxheve dhe investimet e bëra nga resurset financiare të ofruesve të shërbimeve.

3.6.3 Kthimi në kapital

Kërkesat e kapitalit të punës të ofruesve të shërbimeve duhet të përfshihen në VRK por të përshtatura në atë mënyrë që të reflektojnë kërkesat e rrjedhjes së parasë d.m.th. mund të mos përfshihet provizioni i plotë i llogarive të arkëtueshme.

WSPS 18: Kthimi në kapital

Kapitali i punës i Ndërmarrjeve Publike duhet të përcaktohet në bazë të nevojave reale të rrjedhjes së parasë dhe duhet të përfshihet në vlerën rregullatore të kapitalit.

3.6.4 Kthimi në kapital

Ofruesit e shërbimeve duhet të kenë të drejtën për kthimin e drejtë të vlerës kapitale. Norma e kthimit duhet të përcaktohet në bazë të kthimit me rrezikun e caktuar përmes aplikimit të Modelit Tarifor të Aseteve Kapitale (MTAK) ose ngjajshëm. Në mungesë të të dhënave të duhura të tregut, ZRRUM-i mund të përdorë të dhëna zëvendësuese, p.sh. tarifën 'pa rrezik' për bondet e thesarit të Euro-zonës plus rrezikun shtetëror plus rrezikun e premiumeve për sektorin e ujit, p.sh. si është përcaktuar nga OFWAT në përcaktimet e tyre të tarifave.

WSPS 19: Kthimi në kapital

ZRRUM-i duhet të përcaktoj kthimin e duhur në vlerën rregullatore të kapitalit të Ndërmarrjeve Publike. Kjo duhet të përcaktohet në bazë të tarifës pa rrezik/plus rrezikun e sektorit dhe premiumet e përshtatshme të rrezikut shtetëror.

3.6.5 Procesi i vënies së taksave

Derisa ofruesitë e shërbimeve nuk e nxjerrin fitimin e tatueshëm, diskutimi për çështjen e vënies së tatimit mbi fitimin do të ishte i panevojshëm. Çfarëdo takse tjetër e pa-kompensueshme duhet të reflektohet në tarifa kudo që duhet. Kudo që aplikohen taksat, ato duhet të kalojnë në tarifa dhe kthimi në kapital duhet të

bazohet mbi kthimin e “post-taksës” me vlerën e taksës të përfshirë në koston.

WSPS 20: Procesi i vënies së taksave

*Taksat e pa-kompensueshme duhet të përfshihen në tarifa.
Kthimi në kapital duhet të përcaktohet mbi bazën e 'post-taksës.*

4. PROCESI

4.1 Shqyrtimet kryesore të tarifave

WSPS 21: Shqyrtimet kryesore të tarifave

Për vitin 2007/8, tarifat duhet të përcaktohen mbi bazën vjetore në të cilën kohë, politika tarifore mund të përpilohet me një grup të kompletuar të rregullave që mundësojnë periudhat më të gjata në mes të shqyrtimeve.

4.2 Shqyrtimet e përkohshme

Në pajtim me Rregullorën 2004/49, neni 10.5, ZRRUM-i duhet t'i shqyrtoj tarifat çdo vit ose 'në kohë tjetër e cila caktohet në pajtueshmëri me Ofruesin e Shërbimeve...' ZRRUM-i duhet të vendos tarifa në mënyrë periodike me shqyrtim vjetor sipas rregullorës të kufizuar në rregullimin e inflacionit dhe rasteve tjera të jashtëzakonshme.

WSPS 22: Shqyrtimet e përkohshme

ZRRUM-i duhet të bëjë shqyrtimet të përkohshme periodike të tarifave duke marrë parasysh inflacionin dhe ndryshimet e pazakonshme në mjedisin operativ.